



KLGJ
KËSHILLI I LARTË
GJYQËSOR

4 TETOR 2022

Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami, priti në një takim kortezie ambasadoren e Bashkimit Europian në Tiranë, SH.S.Znj. Christiane Hohmann.

Të pranishmit diskutuan mbi procesin e integritimit Europian të Shqipërisë si dhe rolin e institucioneve të pavarura të drejtësisë, veçanërisht atë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, me qëllim plotësimin e standardeve dhe praktikave më të mira Europiane në këtë fushë.

Bashkëbiseduesit e përqëndruan diskutimin e tyre si në rezultatet dhe sfidat e institucionit të KLGJ-së dhe në mekanizmat e ndërmarra prej tij në funksion të rritjes së transparencës, efijencës dhe aksesit të publikut në sistemin gjyqësor përmes zbatimit në praktik të hartës së re gjyqësore dhe digjitalizimit të sistemit.

Ambasadorja u shpreh për mbështetje të vazhdueshme në këto çështje të rëndësishme dhe se asistenca e BE-së nuk do të mungojë.



6 TETOR 2022

Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Komisioni i Prokurimit Publik nënshkruan Marrëveshjen e Bashkëpunimit midis dy institucioneve. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi u nënshkrua nga znj. Naureda Llagami, Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe z. Jonaid Myzyri Kryetar i Komisionit të Prokurimit Publik.

Bashkëpunimi midis Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Komisionit të Prokurimit Publik konsiston në këto drejtime kryesore; realizimin e workshop-eve, konferencave, trajnimeve të përbashkëta; realizimin e analizave dhe studimeve periodike; veprimtari të tjera bashkëpunimi të cilat janë në përputhje me qëllimin e kësaj marrëveshjeje.

Në përfundim të këtij takimi, palët shprehën gatishmërinë e tyre për të kontribuar në zbatimin e marrëveshjes.



7 TETOR 2022

Ditën e sotme, anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, e caktuar për Marrëdhëniet me Median dhe Publikun, znj. Marçela Shehu mori pjesë në konferencën me temë “Liria e shprehjes së gazetarëve nën këndvështrimin e çështjeve gjyqësore penale dhe civile me palë gazetarë për garantimin e një politike të tolerancës zero ndaj frikësimit dhe sulmeve kundër gazetarëve”, e cila u organizua nga Qendra ALTRI.

Të ftuar në konferencë ishin përfaqësues të institucioneve shtetërore, përfaqësues të OSHC dhe gazetarë të cilët diskutuan mbi rolin që kanë institucionet publike mbi përmirësimin e politikave dhe legjisllacionit kombëtar në drejtim të garantimit të lirisë së shprehjes dhe të medias; përvojën e shoqërisë civile në luftën kundër intimidimit dhe sulmeve ndaj gazetarëve; proceset gjyqësore ndaj gazetarëve në sistemin e drejtësisë si dhe hapat prioritarë të nevojshëm në drejtim të përmirësimit të situatës.

Në fjalën e saj, znj. Marçela Shehu prezantoi të gjitha masat konkrete që do të ndërmarrë Këshilli i Lartë Gjyqësor, në lidhje me lehtësimin e procesit të identifikimit të çështjeve ku palë janë gazetarë dhe përfaqësues të medias, si një kërkesë e vazhdueshme e Komisionit Europian në kuadër të vlerësimit të respektimit të lirisë së medias.



PREZANTIMI I “PLATFORMËS SË KOMUNIKIMIT ELEKTRONIK MIDIS GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR TIRANË DHE AVOKATËVE”

Në datë 07.10.2022, në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor në prani të përfaqësuesve të sistemit të drejtësisë, avokatëve, partnerëve ndërkombëtarë dhe mediave, u prezantua “Platforma e komunikimit elektronik midis Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe avokatëve”.

Të pranishëm në këtë aktivitet ishin znj. Naureda Llagami, Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Lenka Vitkova, Drejtuese Seksioni e Delegacionit të BE-së në Shqipëri, znj. Jutta Gützoë, Shefe e Zyrës së Këshillit të Europës në Tiranë, z. Fatmir Braka, Zëvendëskryetar i Dhomës të Avokatisë si dhe përfaqësues të tjerë të grupeve të interesit.

Në fjalën e saj përshëndetëse znj. Naureda Llagami, falenderoi pjesëmarrësit duke shprehur se “kjo platformë synon rritjen e efikasitetit të menaxhimit të çështjeve në gjykata, mbështetjen e palëve të përfshira, veçanërisht të avokatëve që të kenë akses më të mirë dhe më të shpejtë në informacionin e “çështjes gjyqësore”, por njëkohësisht redukton kostot për thirrjet shkresore”.

Gjithashtu znj. Llagami theksoi se “të tilla instrumente do të jenë të domosdoshme veçanërisht, në kuadrin e zbatimit të “Hartës së Re Gjyqësore” duke shkurtuar virtualisht distancën mes gjykatës dhe qytetarit”.

Më tej, fjala i kaloi znj. Jutta Gützoë, Shefe e Zyrës së Këshillit të Europës në Tiranë e cila deklaroi se “Kjo platformë do të ndihmojë edhe në përmirësimin e mbledhjes së statistikave nga gjykata si një indikator i rëndësishëm për një manaxhim më të mirë të gjykatave si dhe për zhvillimin apo implementimin e “Hartës së Re Gjyqësore” në Shqipëri”.

Në vazhdim të aktivitetit, z. Fatmir Braka, Zëvendëskryetar i Dhomës së Avokatisë dhe Kryetar i DHA Tiranë, velëroi këtë projekt duke shprehur se “krijimi i kësaj platforme dhe aksesit elektronik i avokatëve në sistemin me informacione në kohë reale dhe për më tepër në një version “Mobile” do të shmangë zvarritjet e vështirësitë të cilat përcillen aktualisht në kushtet e njoftimit manual nëpërmjet shërbimit postar apo paraqitjes fizike në ambientet e gjykatës”.

Aktiviteti u shoqërua me një prezantim dhe simulim të përdorimit të platformës dhe u përmyll me pyetje dhe diskutime nga të pranishmit në sallë.

Projekti pilot i mbështetur nga programi i përbashkët i BE-së dhe KE-së për “Forcimin e cilësisë dhe efikasitetit të drejtësisë në Shqipëri” (SEIII), shënon një hap përpara drejt digjitalizimit të sistemit të drejtësisë në Shqipëri.



ZV. KRYETARI I KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR, Z.ILIR RUSI MORI PJESË NË KONFERENCËN RAJONALE TË KËSHILLAVE GJYQËSORË TË ORGANIZUAR ME INICIATIVËN E KËSHILLIT GJYQËSOR TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Zv. kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z.Ilir Rusi mori pjesë në Konferencën Rajonale të Këshillave Gjyqësorë të organizuar me iniciativën e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Kjo konferencë u zhvillua në datat 31 tetor-1 nëntor 2022 në Shkup, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Shqipërisë, Kosovës, Malit të Zi, Bosnjë – Hercegovinës dhe të vendit organizator, Maqedonisë së Veriut. Aktiviteti u zhvillua me mbështetjen e projektit MATRA, financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Hollandës dhe zbatuar nga Qendra Ndërkombëtare për Bashkëpunimin Ligjor (CILC).

Qëllimi i konferencës ishte ai i krijimi i një rrjeti bashkëpunimi ndërmjet këshillave gjyqësorë të Ballkanit Perëndimor duke synuar forcimin e bashkëpunimit, përmes shkëmbimit të njohurive dhe praktikave më të mira, mes tyre. Në përfundim të konferencës përfaqësuesit e këshillave gjyqësorë nënshkruan një deklaratë bashkëpunimi për krijimin e Rrjetit Rajonal të Bashkëpunimit për Këshillat Gjyqësorë në Ballkanin Perëndimor.



AKTIVITET PËR SHKËMBIMIN E PËRVOJËS MBI CILËSINË E SISTEMIT TË DREJTËSISË DHE SFIDAT E PËRBASHKËTA MIDIS KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS DHE KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR TË SHQIPËRISË

Në datat 8 dhe 9 nëntor 2022, anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor të Shqipërisë dhe të Këshillit të Lartë Gjyqësor të Kosovës u takuan në Tiranë për të diskutuar mbi sfidat e përbashkëta në lidhje me funksionimin e sistemeve të tyre të drejtësisë.

Diskutimet u fokusuan në statistikat gjyqësore për të vlerësuar efikasitetin, cilësinë dhe reformat gjyqësore, vlerësimin e performancës së gjyqtarit, dixhitalizimin e drejtësisë, përdorimin e mekanizmave alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, menaxhimin e kohës gjyqësore dhe veprimet për të reduktuar çështjet e mbartura, me prezantime nga ekspertë të nivelit të lartë të CEPEJ mbi mjetet, treguesit dhe praktikët e mira të CEPEJ-it.

Gjithashtu, në këtë aktivitet u prezantuan dhe rezultatet e raportit të tretë të Panelit të Ballkanit Perëndimor për vitin 2021.

Ky aktivitet u organizua bashkërisht nga projektet e CEPEJ-it në rajon, përkatësisht KoSEJ II “Forcimi i Cilësisë dhe Efikasitetit të Drejtësisë në Kosovë”, projekti rajonal “Drejt një vlerësimi më të mirë të rezultateve të reformave gjyqësore në Ballkanin Perëndimor – Paneli Ballkani Perëndimor” dhe projekti SEJ III “Forcimi i Cilësisë dhe Eficiencës së Drejtësisë në Shqipëri”, pjesë të programit të përbashkët të titulluar “Instrumentit Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë – faza II”, të bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës dhe të zbatuara nga Këshilli i Evropës.



TAKIM I NIVELIT TË LARTË ME TEMË “DREJT EKSELENCËS GJYQËSORE”

Në datë 13.12.2022, në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, u zhvillua Takimi i Nivelit të Lartë me temë “Drejt Ekselencës Gjyqësore”. Ky takim u zhvillua në bashkëpunim me Projektin “Ulja e numrit të çështjeve të prapambetura dhe përmirësimi i efikasitetit në Gjykatën e Lartë të Shqipërisë”, zbatuar nga Instituti i Menaxhimit Lindje – Perëndim (EWMI), me mbështetjen e Byrosë për Çështjet Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Ligzbatimit, Departamenti Amerikan i Shtetit (INL).

Të pranishëm ishin Ambasadorja e SHBA, SH.S.Zj. Yuri Kim, Zëvendës Presidenti i Institutit të Menaxhimit Lindje-Perëndim z. Mark Dietrich, Zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë z. Sokol Sadushi, z. Pim Albers, Ekspert për Administrimin Gjyqësor si dhe përfaqësues të nivelit të lartë nga institucionet e drejtësisë, trupës gjyqësore dhe aktorë të tjerë që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e drejtësisë.

Në fjalën e saj përshëndetëse Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Znj. Naureda Llagami u shpreh se: “Sot jemi gjithashtu së bashku për të përmbyllur vitin e 4-t të funksionimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Sot është një realitet dhe jo më një vizion, një institucion që jo vetëm funksionon por edhe që menaxhon një nga shtyllat e demokracisë që është pushteti gjyqësor.

Gjithashtu, znj. Llagami theksoi se: “Përmes programeve strategjike që targetuan nevojat tona kryesore dhe veçanërisht disa objektiva madhore si funksionalizimi dhe efektiviteti i Gjykatës së Lartë, mund të themi se jemi ndarë njëherë e përgjithmonë me drejtësinë e vjetër. Ne i jemi falënderues EWMI, INL por edhe partnerëve të tjerë si BE dhe KiE që na kanë mbështetur në ngritjen e një drejtësie të re mbi bazat e integritetit, pavarësisë, profesionalizmit dhe besimit të publikut”.

Duke vijuar në fjalën e saj, Kryetarja e KLGJ- së, deklaroi se: “Për një kohë shumë të shkurtër ne kemi filluar të shohim rezultate me Gjykatën e Lartë e cila po ecën me ritme të cilat urojmë të sjellin një reduktim domethënës të çështjeve që presin drejtësi. Mbi të gjitha sot kemi një model të konsoliduar, i cili mund të përdoret me sukses në të ardhmen edhe në nivelin e apelit”.

Më tej fjalën e mori Ambasadorja e SHBA-ve, SH.S.Zj. Yuri Kim, e cila u shpreh se: “Vazhdoni të ecni sa më shpejt të mundeni. Kjo është një kohë vendimtare për reformën në drejtësi dhe ka arsye për të qenë optimiste për këtë brez shqiptarësh. Reforma në drejtësi po jep rezultate të dukshme, të prekshme, konkrete. Por e dini çfarë? Njerëzit duan më shumë dhe SHBA-të janë në kahun e popullit shqiptar. Ne biem dakord me ta, duhet të ketë më shumë. Kjo nuk është kohë për t’u çlodhur. Ne duhet të festojmë për përparimin që kemi bërë së bashku deri tani. E kemi bërë së bashku, e kemi realizuar së bashku. Ndonjëherë ka qenë e vështirë, nuk mendoj se ka pasur ndonjë kohë kur ka qenë e lehtë, ndonjëherë ka pasur gabime, por kjo është në rregull, ky është një proces njerëzor”.

Takimi vijoi me një prezantim të mbajtur nga z. Mark Dietrich, i cili theksoi rëndësinë që ka patur prezenca dhe mbështetja e Nëpunësve për Uljen e Numrit të Çështjeve të Prapambetura (NUNÇP), në Gjykatën e Lartë për zgjidhjen e çështjeve gjyqësore dhe uljen e numrit të çështjeve të prapambetura, duke e ilustruar me një video.

Gjithashtu, i pranishëm në këtë aktivitet ishte Zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë z. Sokol Sadushi i cili u shpreh se: “Gjykata e Lartë po e kryen funksionin e vet kushtetues të njësimi dhe zhvillimit të praktikës gjyqësore, duke kërkuar vazhdimisht mënyra, mjete dhe rrugë të reja që sigurojnë shpejtësi, korrektësi, cilësi dhe transparencë në vendimmarrje. Ky është një proces i vazhdueshëm që kërkon një vizion të qartë dhe angazhim serioz për t’a realizuar. Prandaj çdo kontribut në këtë drejtim i aktorëve brenda dhe jashtë sistemit gjyqësor, është i mirëpritur. Të tillë e kemi trajtuar edhe ndihmën e pakursyer dhe të vlefshme që ka dhënë projekti drejtuar nga INL me fokus uljen e numrit të çështjeve të prapambetura”.

Në vazhdim fjalën e mori z. Pim Albers, Ekspert për Administrimin Gjyqësor, i cili theksoi nocionet e ekselencës gjyqësore.

Aktiviteti nxori në pah përparimet e bëra falë mbështetjes së Qeverisë së Shteteve të Bashkuara, në konsolidimin e kapaciteteve të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Gjykatës së Lartë të Shqipërisë.



Këshilli i Lartë Gjyqësor, në atributet e tij kushtetuese si garant i pavarësisë, përgjegjshmërisë dhe mbarëvajtjes së pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, shpreh, në mënyrë të përsëritur, shqetësimin e tij për qëndrime të mbajtura nga disa ofrues të shërbimeve mediatike audiovizive si dhe medias së shkruar, të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekt kanë cenuar dhe tronditur në mënyrë të papërgjegjshme dhe vazhduese, besimin e publikut në sistemin gjyqësor.

Rasti i fundit i referohet transmetimit nga emisioni investigativ “Stop”, në datë 12 Tetor 2022, të detajeve të një çështjeve gjyqësore penale, të gjykuar nga gjyqtarja znj.Suela Dashi, shoqëruar me sulme të drejtpërdrejta ndaj saj, me përmbajtje dhe etiketime fyese dhe denigruese. Aktualisht, znj.Dashi, ushtron detyrën e Zëvendëskryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, zgjedhur nga trupa gjyqësore e kësaj gjykate, në mbështetje të nenit 26 të Ligjit nr.98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Këshilli i Lartë Gjyqësor është i vetëdijshëm për të drejtën e publikut për të marrë informacion me interes publik nga njëra anë, dhe detyrimit të medias së shkruar apo audiovizive për përhapjen e këtij informacioni si dhe ideve për publikun, por kjo e drejtë gjithnjë duhet të ushtrohet duke patur në konsideratë kufizimet e imponuara nga pavarësia, autoriteti, paanësia e pushtetit gjyqësor si dhe mbrojtja e reputacionit të gjyqtarit.

Referuar rastit konkret, Këshilli konstaton me keqardhje, jo vetëm mungesën e qëllimit të mirë në trajtimin e çështjes konkrete, por dhe mungesën e përkujdesjes së duhur dhe profesionalizmit të emisionit për të kryer një raportim të saktë, të drejtë, jo paragjykes dhe në respektim të të drejtës për një gjykim të drejtë, në përputhje me etikën e gazetarisë.

Nëpërmjet përndjekjes së gjyqtarës, përdorimit ndaj saj të fjalëve dhe gjeesteve, fyese dhe denigruese, gazetarët e emisionit në fjalë, kanë rrezikuar rëndë dhe vënë në pikëpyetje, në mbarë opinionin publik, të drejtat dhe vlerat njerëzore të gjyqtarës për shkak të kryerjes së detyrës, si dhe mund të rrezikojnë në të ardhmen kryerjen, nga ana e saj apo e aktorëve të tjerë të sistemit gjyqësor, të funksioneve të tyre ligjore dhe kushtetuese.

Këshilli i Lartë Gjyqësor siguron opinionin publik se, në ushtrimin e veprimtarisë së tij bazohet në parimet e ligjshmërisë dhe transparencës dhe se çdo veprim apo sjellje që ka vendosur në dyshim apo përbaltur punën e tij në këtë drejtim, si në rastin konkret, passjell pasoja sipas ligjit. Këshilli është i hapur ndaj çdo lloj kritike konstruktive në funksion të rritjes së besimit të publikut si dhe shpreh gatishmërinë e tij për ndërmarrjen e çdo hapi të nevojshëm që synon vendosjen e standardeve që kanë lidhje me funksionimin dhe mirë administrimin e sistemit gjyqësor, si dhe garanton opinionin publik për marrjen e të gjitha masave të duhura ligjore, duke iu drejtuar edhe organeve kompetente për vlerësimin e qëndrimeve të tilla, të cilat veçse nxisin në publik ndjenjën e armiqësisë ndaj pushtetit gjyqësor, krijojnë imazhin e gabuar mbi gjyqësorin si dhe cenojnë rëndë figurën dhe dinjitetin e gjyqtarit.

Këshilli rithekson se cilido që vjen në dijeni të një veprimtarie apo sjelljeje të gjyqtarit që mund të përbëjë shkelje disiplinore, duhet t’ia referojë atë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas legjislacionit në fuqi, por në asnjë rast nuk mund të cenohet dinjiteti i gjyqtarit.

Këshilli i Lartë Gjyqësor shpreh bindjen se respektimi i gjyqtarëve dhe i funksionit e dinjitetit të tyre, sjell forcim të shtetit të së drejtës, si dhe rrit transparencën dhe përgjegjësinë e pushtetit gjyqësor.

DEKLARATË – 14 NËNTOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka vlerësuar dhe vlerëson rolin dhe qëndrimin kritik të çdo subjekti publik apo privat, e në veçanti të medias së shkruar dhe audiovizive, që kontribuon në rritjen e transparencës dhe efektivitetit të sistemit gjyqësor. Kohët e fundit, me keqardhje, konstaton një rritje të pajustificuar të disa qëndrimeve apo deklaratave me impakt të dukshëm në formimin e opinionit publik, të cilat përveç se shkelin të drejtat njerëzore të gjyqtarëve për shkak të ushtrimit të detyrës, rrezikojnë seriozisht kryerjen e funksioneve ligjore nga ana e tyre.

Rasti i radhës i referohet disa shkrimeve që qarkullojnë në disa media të shkruara online, me autorësi të gazetarit z. Elton Qyno, të shoqëruara me përmbajtje dhe etiketime fyese e denigruese, të cilat synojnë dukshëm dëmtimin e figurës dhe dinjitetit të znj. Etleva Deda, në detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Mediat e shkruara dhe audiovizive, si dhe gazetarët në veçanti, në rastin e raportimeve të çështjeve gjyqësore duhet t'i sigurojnë opinionit publik një raportim të saktë, të drejtë, joparagjykes duke patur në konsideratë kufizimet e imponuara nga pavarësia, autoriteti, paanësia e pushtetit gjyqësor si dhe mbrojtja e reputacionit të gjyqtarit, në mbështetje të etikës së gazetarisë. Referuar rastit konkret, Këshilli sërish konstaton jo vetëm mungesën e përkujdesjes së duhur dhe profesionalizmit në referimin e rastit, por dhe mungesën e qëllimit të mirë në trajtimin dhe pasqyrimin e tij nga ana e gazetarit, e redaksive apo operatorëve të faqeve online, në kundërshtim të hapur me parimet bazë që ofrojnë garancitë e duhura për një gazetari cilësor, etike dhe të përgjegjshme.

Këshilli vlerëson se shkrime të tilla nuk bëjnë gjë tjetër veçse nxisin në publik ndjenjën e armiqësisë ndaj pushtetit gjyqësor, krijojnë imazhin e gabuar mbi gjyqësorin si dhe cenojnë rëndë figurën dhe dinjitetin e gjyqtarit.

Për nga natyra e vet, veprimtaria gjyqësore shkakton pakënaqësi ndaj njëres apo tjetrës palë, por në një shtet të së drejtës, mjeti ligjor për të kundërshtuar një vendim gjyqësor është ankimi në një gjykatë më të lartë, sipas legjislacionit në fuqi, jo përbaltja e gjykatës, apo e gjyqtarit.

Këshilli rithekson se, cilido që vjen në dijeni të veprimi apo sjelljeve të gjyqtarit që mund të përbëjë shkelje disiplinore, duhet t'ia referojë atë, sipas legjislacionit në fuqi, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si dhe shpreh bindjen e tij se respektimi i gjyqtarëve dhe i funksionit e dinjitetit të tyre, sjell forcim të shtetit të së drejtës, si dhe rrit transparencën dhe përgjegjësinë e pushtetit gjyqësor.

DEKLARATA E UNIONIT TË GJYQTARËVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË LIDHJE ME SULMET MEDIATIKE NDAJ GJYQTARËVE

Unioni i Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë, ju drejtohet për të kërkuar ndërmarrjen e masave për situatën e paprecedentë të krijuar së fundmi nga disa media/platforma online, që sulmojnë e kërcënojnë drejtpërsëdrejti gjyqtarë të Republikës së Shqipërisë dhe çenojnë në mënyrë të pajustificuar, besimin e publikut tek drejtësia.

Unioni vëren me keqardhje se, në një kohë që media e shkruar dhe ajo televizive, përbëjnë një faktor të rëndësishëm në rritjen e transparencës në gjyqësor, kohët e fundit, një sërë artikujsh mediatik, me përmbajtje fyese, denigruese e të pavërtetë, që çenojnë rëndë imazhin e gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë, kanë qarkulluar në mediat online.

Kështu, sjellim në vëmendje se, më datat 18.10.2022, 06.11.2022, 13.11.2022, 14.11.2022, 15.11.2022, 16.11.2022, artikuj të publikuar në faqet “prapaskena.com”, “demaskimi”, “in-front.org” etj, apo të shkruar nga gazetar (individ), kanë sulmuar personalisht Zv.kryetarin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, Zv.kryetaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, një gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, një gjyqtare pranë Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar si dhe Kryetaren e Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke aluduar për histori që as nuk i korrespondojnë realitetit, as sjellin ndonjë benefit për publikun. Gjuha e përdorur ka qenë një gjuhë fyese, intimiduese, kërcënuese, duke përbërë qartazi krim urrejtjeje, përveç shpifjes ndaj një gjyqtari, si funksionar i sistemit të drejtësisë.

Unioni vëren me keqardhje se, rastet e mësipërme reflektojnë vetëm disa shembuj të sulmeve mediatike të pajustificuara ndaj gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë, ndërkohë që përbëjnë sulm ndaj gjyqtarëve për shkak të detyrës, duke synuar intimidimin, kërcënimin dhe ndikimin e paligjshëm të tyre nëpërmjet përndjekjes mediatike.

Unioni vëren njëkohësisht se, në një kohë që liria e shtypit përbën një prej lirive themelore të një shteti demokratik, ajo ushtrohet në respektim të garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, e asnjëherë si formë presioni e ushtrimi ndikimi të paligjshëm.

Për pasojë, Unioni fton të gjithë mediet serioze që të jenë pjesë e procesit të rritjes së llogaridhënies e transparencës në gjyqësor, e për të kontribuar së bashku në forcimin e besimit të publikut tek drejtësia.

Unioni i Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë, njëkohësisht kërkon marrjen e masave të menjëhershme si më poshtë:

- Reagimin e menjëhershëm të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) për të ndërmarrë masa për identifikimin e zotëruesve të këtyre portaleve e çdo portali/ subjekti që do të veprojë në të njëjtën formë të kundërligjshme në të ardhmen dhe paraqitjen e kërkesës për mbylljen e tyre, për shkak të kryerjes së veprave penale të shpifjes, fyerjes së gjyqtarit, si dhe për shkak të përdorimit të gjuhës së urrejtjes.
- Fillimin e procedimit penal e kryerjen e hetimeve të menjëhershme për rastet e sipërcituara.
- Veprimin automatik e të menjëhershëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Prokurorisë, kundrejt çdo individ apo subjekti publikues, që me veprimet e tij ka shfaqur apo do të shfaqë në të ardhmen, gjuhë urrejtjeje duke kërcënuar kështu mediatikisht gjyqtarët e Republikës së Shqipërisë.
- Reagimin e menjëhershëm të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për konstatim të diskriminimit mediatik, nëpërmjet përdorimit të gjuhës së urrejtjes dhe përndjekjes mediatike, për shkak profesioni dhe/ose përkatësie gjinore.


MASAT E MARRA PËR FUNKSIONALITETIN E SISTEMIT GJYQËSOR

- Në kuadër të procesit të vlerësimit etik profesional të gjyqtarëve si dhe atij të ngritjes në detyrë, Këshilli gjatë 3 muajve të katërt 2022 ka vendosur miratimin e **5 raporteve të vlerësimit etik dhe profesional, për 5 gjyqtarë**.
- Këshilli, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale dhe mbas shortit të realizuar, miratoi vendimin për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të **3 gjyqtarëve** që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit.
- Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës të Apelit Korçë të **z. Dritan Hasani**; në detyrën e gjyqtarës së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të **znj. Flojera Davidhi**; në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të gjyqtarës **znj. Tereza Merkaj** dhe gjyqtarit **z. Florjan Kalaja**.
- Këshilli shqyrtoi dhe miratoi vendimin për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 125, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- Gjithashtu, ka miratuar vendimet përkatëse për verifikimin e plotësimit të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.178, datë 11.05.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit, për **3 gjyqtarë**. Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, Këshilli miratoi vendimet përkatëse për kualifikimin e tyre dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e sipërcituar.
- Në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse dhe pas procedurës të shortit, Këshilli ka vendosur caktimin e relatorit për fillimin e procedurave të përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë, të kandidatëve nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 178, datë 11.05.2022.
- Në vazhdim të kësaj procedure, Këshilli miratoi vendimin për kualifikimin e **1 kandidati** dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 178, datë 11.05.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- Po kështu, nëpërmjet procedurës së shortit për caktimin e relatorëve dhe nëpunësve përgjegjës për vlerësimin, Këshilli vendosi për fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, viti kalendarik 2021, për gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 178 datë 11.05.2022.

- Gjithashtu, Këshilli ka miratuar vendimin për kualifikimin e **1 kandidateje** dhe vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 571, datë 07.12.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- Në kuadër të procesit të plotësimit të pozicioneve të lira, Këshilli ka vendosur hapjen e **3 pozicioneve të lira**, për procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; dhe **3 pozicione të lira** përkatësisht për Gjykatën e Apelit Tiranë, Durrës dhe Korçë.
- Ndërkohë ka përfunduar procedura e ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 571, datë 07.12.2021, për **1 kandidat**.
- Gjithashtu, Këshilli hapi procedurën e **transferimit të përkohshëm për 1 pozicion të lirë** në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura.
- Në fokus të veprimtarisë së tij gjatë këtyre muajve, Këshilli ka pasur edhe procesin e plotësimit të vendeve vakante në gjykata përmes skemës së delegimit, në të cilën u përfshinë **2 gjyqtarë**, zgjatjen e afatit të caktimit në këtë skemë për **2 gjyqtarë** dhe përsëritjen e transferimit të përkohshëm me pëlqim për **1 gjyqtarë**.
- Në kuadër të përgjegjësiave mbi rekrutimin e gjyqtarëve të rinj, Këshilli, në vijim të procedurave të verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore, përfshirë dhe pasurinë e figurën, të kandidatëve për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2022-2023, profili gjyqtar, vendosi **kualifikimin e 41 kandidatëve**; si dhe **skualifikimin e 1 kandidati**, për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, për vitin akademik 2021-2022.
- Gjithashtu, KLGJ-ja ka vendosur kualifikimin e **2 kandidateve fituese, profili ndihmës ligjor**, në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, viti akademik 2022 – 2023.
- Këshilli ka miratuar vendimin për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të **znj. Irena Zhurka**, në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Durrës; si dhe të **znj. Gersiana Skifteri, znj. Esida Bruçi, znj. Nertila Kalanxhi, z. Sokol Loçi** dhe **znj. Enkelejda Patrioti**, në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.
- Gjithashtu, Këshilli ka miratuar vendimin për emërimin e përkohshëm të **znj. Klaida Muçaj**, në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
- Ndërkohë ka përfunduar verifikimi i kritereve ligjore duke vendosur kualifikimin për të marrë pjesë në provimin e vlerësimit profesional të kancelarit në detyrë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë si dhe është miratuar vendimi për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor të kancelarit në detyrë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër.
- Me qëllim ruajtjen e integritetit gjyqësor, gjatë kësaj periudhe Komisioni Disiplinor ka shqyrtuar paraprakisht kërkesën ardhur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, për fillimin e procedimit disiplinor, ndaj magjistratit z. {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë {...}, me objekt “Vërejtje publike”, dhe me anë të vendimit nr. 436, datë 25.10.2022, Këshilli ka konkluduar në pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit deri në marrjen e formës së prerë të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
- Në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse, pas procedurës të shortit, Këshilli ka vendosur caktimin e relatorit për zhvillimin e procedimit disiplinor nr. 3/2022, të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}. Në mbledhjen plenare të radhës, Këshilli miratoi vendimin për caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kësaj kërkesë. Në përfundim të seancës dëgjimore, të zhvilluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, u vendos shtyrja e seancës dëgjimore për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit, në fuksion të garantimit të mbrojtjes efektive dhe procesit të drejtë ligjor.
- Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar vendimet për mbarimin e statusit për **2 magjistratë**.
- Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar vendimin për komandimin e gjyqtarit **z. Florin Demollari** në pozicionin e Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë.

- Këshilli ka miratuar udhëzimin për përdorimin dhe hedhjen e të dhënave në Sistemin e Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur, nga gjykatat e Republikës së Shqipërisë.
- Në përmbushje të detyrimeve ligjore, si organ përgjegjës për mbarëvajtjen e marrëdhënieve të gjyqësorit me publikun, Këshilli ka caktuar në **pozicionin e gjyqtarit për Mediat, pranë Juridiksionit të Gjykatës së Apelit Durrës, z. Sokol Pina.**

Veprimtaria e KLGJ-së (Tetor-Dhjetor 2022):



- 25 mbledhje plenare
- 158 akte të miratura në ndihmë të të gjithë sistemit gjyqësor, më konkretisht:
 - 11 akte kolektive, Tetor 2022
 - 17 akte kolektive, Nëntor 2022
 - 15 akte kolektive, Dhjetor 2022
 - 20 akte individuale, Tetor 2022
 - 59 akte individuale, Nëntor 2022
 - 23 akte individuale, Dhjetor 2022

Pjesa tjetër përfshihen rregulla të brendshme, aktet e miratimit të procesverbaleve të mbledhjes plenare dhe hartimin e aktit nënligjor me karakter normative si dhe udhëzime.

TRANSPARENCA



Me qëllim plotësimin e trupave gjyqësore, Këshilli i Lartë Gjyqësor trajtoi **129 kërkesa për caktimin e 173 gjyqtarëve** të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme.

KLJGJ, në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit, gjatë kësaj periudhe, ka trajtuar **6 kërkesa për informacion**, të ardhura si përmes postës elektronike ashtu edhe në rrugë zyrtare, të cilat morën përgjigje brenda një afati të arsyeshëm.

Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun me Jashtë dhe Botimet ka trajtuar **159 shkresa** të cilat janë paraqitur nga qytetarë, organizata dhe institucione publike dhe jopublike si dhe ka vijuar bashkëpunimin e frytshëm dhe intensiv me partnerët ndërkombëtarë, organizata të shoqërisë civile, si dhe institucionet më të rëndësishme të vendit si Kuvendi, Ministria e Drejtësisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Shkolla e Magjistraturës, etj.

Këshilli i Lartë Gjyqësor në mbledhjen plenare të datës 02.11.2022 ka miratuar vendimin për Planin e Komunikimit për Gjykatat.

Ky plan komunikimi dy-vjeçar vjen në zbatim të Planit Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor, të miratuar më parë nga KLGJ dhe është i harmonizuar me misionin, vizionin dhe vlerat thelbësore të pushtetit gjyqësor. Ai shërben si një pikënisje për të strukturuar mënyrën se si gjykatat i përqasen publikut dhe aktorëve të tjerë të interesit gjatë një procesi komunikimi e ndërveprimi.

Hartimi i tij është udhëhequr nga standardet dhe parimet ndërkombëtare duke reflektuar praktikën më të mira të krijuara nga zbatimi i modeleve ekzistuese të planeve të komunikimit të gjykatave në rajon, nivel evropian e më gjerë.

Projektplanin e Komunikimit u është dërguar për konsultim të gjithë gjykatave, gjyqtarëve të medias dhe njësisë përgjegjëse pranë KLGJ-së si dhe i është nënshtruar procesit të konsultimit dhe me partnerët ndërkombëtarë që mbështesin Këshillin.

“Plani i Komunikimit për Gjykatat” shoqërohet me një Plan Veprimi me ide dhe mjete praktike për ta bërë komunikimin më të lehtë, më të kuptueshëm dhe me sa më shumë ndikim në drejtim të rritjes së transparencës, nivelit të informimit, cilësisë së shërbimeve, profesionalizmit dhe për rrjedhojë, besimit të publikut në sistemin gjyqësor.

Sipas vendimit të miratuar nga Këshilli, në kuadër të zbatimit dhe monitorimit të Planit të Veprimit, secila gjykatë do të përcaktojë punonjës të përgjegjës, i cili mund të jetë gjyqtari/nëpunësi për marrëdhënien me median dhe publikun, koordinatori i të drejtës së informimit ose çdo person tjetër i përcaktuar prej tyre me funksionet e marrëdhënies me median dhe publikun.

Nevoja për hartimin e këtij vendimi vjen në zbatim të detyrimeve ligjore të përcaktuara në nenin 91 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë,” ku parashikohet se KLGJ është përgjegjës për mbarëvajtjen e marrëdhënieve të gjyqësorit me publikun dhe median.

Plani i Komunikimit është produkt i bashkëpunimit të ngushtë të KLGJ me Qendrën ALTRI dhe me Projektin “Ulja e Numrit të Çështjeve të Prapambetura dhe Përmirësimi i Efikasitetit të Gjykatës së Lartë të Shqipërisë”, të zbatuar nga EWMI dhe të mbështetur nga INL, i cili ofron mbështetje teknike për KLGJ në përmbushjen e objektivave strategjike.



KLJ FACEBOOK

Ndjekës në total

2452

-na ndiqni-

Adresa: Godina “Poli i Drëjtësisë”, Rruga “Ana Komnena”, Tiranë

www.klgj.al

e-mail: kontakt@klgj.al